- a) Punë të ngjashme objekt prokurimi për një objekt të vetëm me vlerë minimalisht sa vlera e përllogaritur të kontratës që prokurohet të realizuar gjatë tri viteve të fundit.
- b) Punë të ngjashme objekt prokurimi deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë tre viteve të fundit është në një vlerë sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet

Plotesimi i njerit prej dy kushteve te siperpermendura e ben oferten te kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Deklaratën sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
 2. Kontratë
 3. Situacionin përfundimtar;
 4. Aktin e kolaudimit;
 5. Faturat perkatese tatimore e situacionit përfundimtar
- b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
1. Kontrate;
 2. Situacionin përfundimtar;
 3. Akt kolaudimi objekti;
 4. Fatura tatimore per cdo situacion punimesh.

Kontrata te ngjashme konsiderohen te vlefshme nese zerat kryesore te punimeve kane volume te krahasueshme me keto te përcaktuara per kete prokurim.

2.3.2. Operatorët ekonomik duhet te disponojne licensat e nevojshme per zbatimin e kontrates . Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr.42, datë 16.1.2008: **“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”**. Liçenca e shoqërisë duhet të jetë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

Liçenca e shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- | | |
|---|----------|
| • N.P-1 (Punime germimi e toke) | Niveli A |
| • N.P-5 (Punime nentokesore, ura vepra,) | Niveli A |
| • N.P-9 (Punime dhe mrojtje lumre,) | Niveli A |
| • N.P-12 (Punime te inxhinjerise se mjedisit) | Niveli A |
| • N.S.-18 (Punime topogjeodezike,) | Niveli A |

sipas modelit të lëshuar nga MPPT;

Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Dokumenta Standarde të Tenderit

2.3.3. Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt të përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtem si dhe të ketë eksperiencë pune minimum 10 (dhjetë) vjet.

- i. Libreze pune (perkatëse)
- ii. CV perkatëse
- iii. Kontrate pune e vlefshme (përkatëse)
- iv. Diplomë

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarime të rene do të veprohet në përputhje me nenin 13, pika 3, gërma a, të Ligjit 9643, dt 20.11.2006 i ndryshuar “Për Prokurimet Publike”

2.3.4. Kerkesat e cilesise. Kandidati/ofertuesi duhet te paraqese:

- Çertifikaten për menaxhimin e cilësive të punimeve ISO 9001-2015 ose ekuivalente (e vlefshme/ ose perditesuar) leshuar nga institucione zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- Çertifikate për menaxhimin e shëndetit dhe sigurimit në punë OHSAS-18001-2007 ose ekuivalente (e vlefshme ose e perditesuar) leshuar nga institucione zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- Çertifikate për menaxhimin e mjedisit ISO 14001-2015 ose ekuivalente (e vlefshme ose e perditesuar) leshuar nga institucione zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- Çertifikate SA 8000-2014 “Për përgjegjësitë sociale të lidhura me personelin” ose ekuivalente (e vlefshme ose e perditesuar), leshuar nga institucione zyrtare të akredituara për këtë qëllim.
- Çertifikatat e cilësisë sipas Standartit SA 8000:2014 ose ekuivalente (për sistemin e menaxhimit të përgjegjësive shoqërore), e vlefshme.

Certifikatat duhet të jenë në gjuhën shqipe. Në rast se janë në gjuhë të huaja duhet të paraqiten të përkthyer si dhe të noterizuar.

2.3.5. Kandidati/ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion që vërteton që për periudhën gjashtë muajt e fundit nga data e zhvillimit të tenderit (duke përfshirë edhe muajin gusht 2020) ka pasur të punësuar për këtë periudhë mesatarisht jo më pak se 40 punonjës (duke përfshirë edhe stafin teknik menaxherial).

Për këtë, dokumentacioni që duhet të paraqesë është:

- a. Vërtetim nga sig shoqërore apo dega tatimeve për numrin e të punësuarve dhe që u janë paguar detyrimet për kontributet e tyre për secilin muaj të periudhës së mesiperme,
- b. Liste pagesat e konfirmuar nga administrata tatimore për secilin muaj të kësaj periudhe (elektronike).

2.3.6. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre punonjësit e mëposhtem, të cilët duhet të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe të rezultojnë në listpagesat e

Dokumenta Standarde të Tenderit

shoqërisë për te pakten 6 muajt e fundit, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, libeze pune.

- Inxhinier Ndertimi 1(një)
- Inxhinier Mjedisi 1(një)
- Inxhinier Hidroteknik 1(një)
- Inxhinier Topograf/Markshejder 1(një)

(Gjithë drejtuesit teknik duhet te jene te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të)

2.3.7.Të ketë në stafin e punonjesve te pasqyruar ne list pagesat e shoqërisë për tre muajt e fundit të pakten 8 (tete) punonjës të pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik nga ISHTI ose nga institucione ekuivalente me të, si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, ku nga keta te jene te pakten:

- 2 Teknik Ndertimi (vertetuar dhe me diplome)
- 1 Murator
- 2 Specialist Ndertimi

(Per punonjesit e siperpermendur te paraqiten deshmitë perkatëse te kualifikimit te sigurimit teknik, kontratat e punes te vlefshme).

2.3.7.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (kater) punonjës manovratorë te mjeteve te renda, nga cilet te jene minimalisht 2 automakinist dhe 1 eskavatorist. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, lejen e drejtimit (të vlefshme), Deshmine e Aftesise Profesioale D.A.P (te vlefshme), Certifikata e Aftesimit Profesional (C.A.P), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë. Keta punojes duhet te jene te pajisur me deshmi te kualifikimit Teknik (te vlefshme) per MANOVRATORE.

2.3.8.Operatori duhet te kete ne staf te punësuar:

- a. 1(nje) prej ixhinierëve, pjese e drejtuesve Teknik te shoqerise duhet te jete i certifikuar si Eskpert per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis (minimum 10 vjet eksperience).

(Për ekspertin e Mjedisit certifikata e ekspertit Mjedisor si dhe Kontrata e punes e vlefshme per te pakten periudhen e parashikuar te ndertimit si dhe të rezultojë në listpagesat e shoqërisë për te pakten 6 (gjashte) muajt e fundit.

- b. 1(nje) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqerise, duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit për *"Pergjegjes per sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit ne Pune"*, *"Pergjegjes per sigurine"*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj,
- c. 1(nje) nga inxhinieret pjese e drejtuesve teknik te shoqerise, duhet te jete i pajisur me certifikaten te Trajnimit për *"Vleresimi dhe dokumentacioni i vleresimit te risqeve ne kantier"*, *"Pergjegjes per sigurine"*, e dhëne nga nje organizem i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj.

Dokumenta Standarde të Tenderit

d. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij, 1(nje) person të certifikuar për “*Ndihmen e pare dhe ndërhyrje ndaj emergjencave*”, i cili duhet të figurojë në listepagese minimalisht për 6 muajt e fundit.

2.3.9.Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë 1(nje) mjek ndërmarrjeje, kjo të vërtetohet me paraqitjen Urdhër mjeku, diplomë, CV, librezë pune dhe Kontratës së Punës së mjekut me operatorin ekonomik e cila duhet të jete detyrimisht noteriale dhe e vlefshme për periudhën e ndërtimit.

2.3.10.Operatori Ekonomik duhet të jete i licensuar nga QKB me Licence III.2.A(1+2) "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis"-Veprimtarite e ekspertizes lidhur me ndikimin në mjedis.

2.3.11.Operatori Ekonomik duhet të jete i licensuar nga QKB me Licence III.2.B() "Sherbime Ekspertize dhe/ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis"-Veprimtarite e tjera profesionale lidhur me ndikimin në mjedis-Grumbullim dhe transport i mbetjeve të Ngurta.

2.3.12.Operatori ekonomik, nisur nga percaktimet e pikes 1 a/b të nenit 46 të ligjit 9643 “*Per Prokurimin Publik*”, pikes 5 të nenit 26 të VKM Nr 914 date 29.12.2014 “*Cdo kriter i vecante duhet të jete në përputhje me natyrën dhe permasat e kontrates*” si dhe duke pare tipologjinë e zberthimit të punimeve sipas VKM 629 datë 13.05.2015 “*Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre*”, duhet të jetë i pajisur me dokumentacionin e nevojshëm për zbatimin e kontratës së tenderit, në përputhje me ligjin.

Për këtë arsye duhet të paraqese:

a). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin **çertifikatat e cilesise ISO 9001-2015, dhe QKL perkatese perfshi Lejet perkatese qe duhen marre per keto impiante** për prodhimin ose furnizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Inerte,**

b). Operatorët Ekonomikë duhet të jenë të pajisur dhe të paraqesin çertifikatat e cilesise **ISO 9001-2015**, shoqeruar me testet e materialeve dhe certifikatat e konformitetit **EN 10223-3:2013 ose 2014**, shoqeruar me kataloget perkatespër prodhimin ose furnizimin/autorizimin e materialeve që do përdoren në ndërtimin e objektit ku të përfshihen: - **Rrjete per gabiona, tel i zinguar per gabiona.**

Për plotësimin e pikave pika a, b, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në rast se nuk janë vetë prodhues apo furnizues të këtyre mallrave duhet ta dokumentojnë duke paraqitur Autorizimet/Kontratat e furnizimit përkatëse si dhe certifikatat e sipër kërkua për secilin prej mallrave si dhe një vetëdeklarim që është konform sistemeve të menaxhimit të cilësisë.”

2.3.13. Deshmi për mjetet e pajisjet teknike që ka në dispozicion apo mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:

Dokumenta Standarde të Tenderit

| Nr | LLOJI I MAKINERIVE | PRONESIA | SASIA |
|----|--|------------------------|--------|
| 1. | Kamion veteshkarkues minimalisht 15 ton | ne pronesi ose me qera | Cope 2 |
| 2. | Kamion veteshkarkues minimalisht 3.5 ton | ne pronesi ose me qera | Cope 2 |
| 3. | Minieskavator | ne pronesi ose me qera | Cope 2 |
| 4. | Eskavator me goma / Fadrome | ne pronesi ose me qera | Cope 2 |
| 5. | Kamiocina veteshkarkuese 1.5 ton deri ne 2 ton | Ne pronesi ose me qera | Cope 1 |

Të paraqiten mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 30 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimumi 2 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 2copë
- Komplet i ndimës së shpejtë minimumi 5 copë
- Uniforma pune 30 cope
- Jelek pune 30 cope
- Doreza pune 10 cope
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 5 cope.

Per mjetet ne pronesi qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e mjetit (leja e qarkullimit), certifikata e pronesise , Certificate e Kontrollit Teknik ,Policën e sigurimit të detyrueshem te mjeteve dhe leje transporti nga njesia vendore perkatese nga bashkia apo njesia administrative per vete ose te trete.

Per mjetet e tjera qe nuk shenohen ne rregjistrat publike duhet te paraqiten dokumenti qe verteton pronesine e tyre.

Per mjetet e marra me qera, formularit dhe dokumentave te mesiperme t'i bashkelidhen kontrata perkatese noteriale te qerese, ku te jete specifikuar detyrimisht edhe emri i objektit per te cilen eshte bere kontrata e qiramarjes/ si dhe duhet qe afati i marrjes me qira, te perfshije afatin e realizimit te kesaj kontrate ne rast te shpalljes fitues.

Per secilin prej mjeteve te paraqiten fotografi te tyre.

2.3.14. Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese, qe makineritë e mësipërme nuk do të jenë të angazhuara në kontrata të tjera por do te jene te angazhuara vetem per kontraten e objektit ne fjale.

2.3.15. Deklaratë nga administratori i shoqërisë ofertuese per vendodhjen e mjeteve ne pronesi apo te marra me qira dhe autorizim per verifikimin e tyre nga AK ne cdo kohe deri ne shpalljen e fituesit. Ne rast se ofertuesi eshte bashkim i operatoreve, cdo anetar i ketij bashkimi duhet te paraqese kete dokument. *Sqarim : Autoriteti Kontraktor per te vertetuar vertetesine e shtojces 10, te plotesuar nga OE, ka te drejte ne cdo kohe te verifikojte vendodhjen e percaktuar nga OE per mjetet dhe disponueshmerine e tyre. Ne rast se mjetet e deklaruar sipas shtojces 10 nuk gjenden ne vendin e percaktuar nga OE , AK ka te drejte te skualifikoje OE per mospermbushje te kriterit.*

2.3.16. **Grafiku i punimeve** në përputhje me zërat e punës të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit, kjo në respektim të Vendimit Nr. 914 datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.3.17. Operatori ekonomik/ofertuesi pjesëmarrës në tender së bashku me dorezimi e preventivit duhet të dorëzoj **analizat teknike** për të gjithë zerat e punimeve ne preventivin të ofertës. (Referuar VKM Nr.514, datë 15.8.2007 Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve ne ndertim.

2.3.18. Cdo ofertues duhet te paraqese **Planorganizimin dhe Planin e Sigurise ne Kantier** per punimet ne objekt sipas VKM nr 692 date 13.12.2001 ”Per masat e vecanta te sigurimit dhe te ruajtjes se shendetit ne pune” i ndryshuar.

- Operatoret e huaj ekonomike, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin e tyre në gjuhën shqipe (si gjuhë e ofertës), të bëjnë noterizimet përkatëse si dhe të jenë të certifikuara “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës datë 5 tetor 1961, “Për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat, konsullatat ose zyrat respektive nga vendi i origjinës.

-Kandidatët/ofertuesit duhet të përmbushin kërkesat ligjore të parashikuara në nenin 45 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006.

-Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Ne respektim te nenit 23 te LPP-se ne te gjitha rastet kur permendet “marke” perfshihet termi “ekuivalent”.

Në çdo rast, gjatë procesit të vlerësimit të ofertave Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kërkoje kopjen origjinale të dokumentacionit të paraqitur nga operatorët ekonomik ofertues. Rastet e mos-dorëzimit të dokumentacionit origjinal brenda afatit të kërkuar nga AK, konsiderohen si kusht për skualifikim.

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PROJEKTI I ZBATIMIT DHE SPECIFIKIMET TEKNIKE

.

Përshkrim i punëve

Grafiku i Punimeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Specifikimi i Materialeve, Skicimet, parametrat teknik etj:

Pwrshkrimi i tw dhwnave teknike tw mallrave objekt prokurimi tw përshkruara sa më saktë dhe në mënyrë të plotë, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara

KUJDES

Dokumenta Standarde të Tenderit

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë te ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalent” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 13

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

PREVENTIVAT E PUNIMEVE

Shtojca 14.

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDART PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR³

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar Z. /Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimet Publike”.

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s’kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme:

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi siç parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< **Emri** >

³ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore.

Shtojca 15

[Shtojcë për tu plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumenta Standarde të Tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [*emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues*] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [*shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*]/pikët totale të marra [_____]është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [*vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra*], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM
NË MARRËVESHJEN KUADËR**

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti , kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *[Data]* *[Numri]*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*
2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it*

Dokumenta Standarde të Tenderit

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

2. _____

Emri i plotë i shoqërisë

numri i NIPT-it

Vlera _____ / Pikët totale të marra _____

(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marreveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____

(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 17

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS Punët –Kërkesë për propozim

Neni 1: Qëllimi

- 1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruarra ne bazë të legjislacionit të prokurimit.
- 1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.
- 1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.
- 1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.
- 1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

Neni 2: Përkufizime

- 2.1 “Preventiv total” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.
- 2.2 “Preventiv për njësi” do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njësi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.
- 2.3 “Afati i realizimit te punimeve” do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.
- 2.4 “Kontratë” do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.
- 2.5 “Cmim kontrate” do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

Dokumenta Standarde të Tenderit

- 2.6 “Realizimi i punimeve” do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.
- 2.7 “Defekt” do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.
- 2.8 “Data e hyrjes” do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.
- 2.9 “Data e fillimit” është përfshirë në Të dhënat e kontrates. Ajo është data kur kontraktori do të fillojë punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, “data e fillimit “do të jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.
- 2.10 “Pajisje” do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.
- 2.11 “Materiale” do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.
- 2.12 “Objekt i kontratës” do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.
- 2.13 “Palë(t)” do të thotë nënshkruesit e kontratës.
- 2.14 “Drejtues projekti” do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.
- 2.15 “Autoritet Kontraktor” do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe që kontraktori punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo që përdoret ka kuptim të njëjtë me atë të perkufizuar në ligj.
- 2.16 “Kantier” do të thotë vendi fizik i Punimeve.
- 2.17 “Raport i inspektimit të kantierit” do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojnë informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.
- 2.18 “Nënkontraktues” do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.
- 2.19 “Kontraktor” do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.
- 2.20 “Standarde Teknike” do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarde të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose perkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.
- 2.21 “Ngritja e kantierit” do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluar, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndertimit.

2.22 “Punime” do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

Neni 3: Hartimi i Kontratës

3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të shërbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

Neni 4: Praktikrat e Korrupuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korrupuara. Veprimet e korrupuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 5: Informacioni Konfidencial

5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar që nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontratës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premtion ruajtjen e kofidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

Neni 6: Prona Intelektuale

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose përgatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

- 6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.
- 6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

Neni 7: Origjina e Materialeve

- 7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.
- 7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.
- 7.3 Për qëllime verifikimi, “origjinë” do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.
- 7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit

- 8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor
- 8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

Neni 9: Komunikimi

- 9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

Neni 10: Bashkepunimi në Kantier me të Tjerët

- 10.1 Kontraktori duhet të bashkepusojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikon e realizimit të punimeve.

Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

- 11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të

projekteve të Autoritetit Kontraktor me përjashtim të rastit kur keto të fundit, kishin gabime të dukshme që mund të ishin konstatuar lehtësisht nga kontraktuesi.

Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

- 12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.
- 12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet

- 13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.
- 13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vënë re dhe ta kishte reklamuar këtë të Autoriteti Kontraktor.
- 13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë ekzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve

- 14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhë atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

Neni 15: Ngritja e Kantierit

- 15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes së Kantierit.
- 15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

- 16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.
- 16.2 Kontraktori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike të rezezueshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

Neni 17: Zbulimet

- 17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen për të vepruar konform legjislacionit në fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhëzimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

Neni 18: Disponimi i Kantierit

- 18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktori i lind e drejta të kërkojë amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

Neni 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit

- 19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .
- 19.2 Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 20: Paralajmërimi në Kohë

- 20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

Neni 21: Kontrolli i Cilësisë

- 21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.
- 21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.
- 21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.
- 21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara

- 22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarisë koston e korrigjimit

të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontraktor

23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit të Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

- (a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.
- (b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në atë masë që lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

Neni 25: Sigurimi

